



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

### RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Fatmir Krasniqi</b>	<b>26.04.2024</b>	<b>30.04.2024</b>	<b>2024/0350</b>

#### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.04.2024, OE N.T.P "HAJDINI COMERC ". adresa ASHANAJKA P.N. Gllogovc ka parashtruar ankese me nr: 2024/0350, kunder njoftimit mbi vendimin e AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me artikuj ushqimor, për lot 5 me nr. te prokurimit: UA/2016-23-9179-1-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlerë e madhe, vlera e parashikuar për lot 5 është 1,050,000.00€. Konform nenit 113, 114 te Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues.

#### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1, Qëllimi, par 1; 2 dhe 3.

Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1 dhe 2.

Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6 4 |9

Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve, par 4

Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1

Neni 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, par 8;

Neni 71, Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj

Ekonomik, par 2

Neni 105, Kompetencat e OSHP-së

Neni 108/A, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, par 8, nen par 8.4

Rregullorja nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejshëm të i referohemi RRPP) dhe atë:

Neni 26, Grup i Operatorëve Ekonomik

Neni 38, sqarimi i tenderëve

Neni 40, Ekazminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 97 Shkeqje të rënda

## KRITERET PËR VLERËSIM

**Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë**

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i komisionit të rivlerësimit është i nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe me datë 29.03.2024 është ngritë në platformën elektronike E-prokurimi. Në raport janë përshkruar se komisioni është mbështetur dhe ka zbatuar vendimin e OSHP-se me nr 964/23 të datës 15.03.2024, duke e eliminuar ofertën e Dauti Komerc AD Saraj Shkup, Gërlicë, 70000, Ferizaj, Kosovë për Lot 3 ndërsa për lot 5 është rekoamnduar për kontratë me arsyetimin se në këtë Lot, nuk ka produkte të qumështit. Komisioni i rivlerësimit, për Lot 3 tani kanë rekomanduar për kontratë N.T.P "HAJDINI COMERC".

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

**PSH 964/23 i datës 15.03.2024**

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - N.T.P "HAJDINI COMERC "

### Sqarim Hyrës

OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP ka ngritë pretendime ankimore të cilat paraprakisht përmes vendimit nr.964/23 të lëshuar me datë 15.03.2024 ishin trajtuar dhe janë konsideruar si të bazuara, dhe sipas vendimit të OSHP-se nga AK ishte kërkuar që për aktivitetin e prokurimit të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës duke e kthyer lënden në ri-vlerësim.

Konstatimet për aprovim të pretendimeve ankimore si të bazuara janë sikur në ekspertizën me nr. 964/23 dhe në vendim e Panelit Shqyrtues me nr. 964/23 të lëshuar me datë 15.03.2024. Përkundër qe vendimi ka rezultuar me rivlerësim nënkupton se pretendimet ankimore kanë qenë të bazuara dhe AK ka pas për obligim që te evitoj shkeljet e konstatuara ne raport të ekspertizës dhe ne vendimin e PSH-së dhe ti korrigjoj ato përmes rivlerësimit, por AK nuk ka ndryshuar rezultatin me rastin e ri-vlerësimit.

Më tej, eksperti shqyrtues sqaron se, mbetet në përgjegjësi dhe diskercion të Autoritetit kontraktues, respektivisht ZPP-së vendosja e kriterëve të përzgjedhjes, vlerësimi i ofertave, ashtu që arsyet e eliminimit duhet të bëhen në harmoni të plotë me nenin 56 paragrafi 3 i LPP-së në mënyrë që lejojnë trajtim të barabartë në mes operatorëve ekonomik, të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën.

Po ashtu në kuptim të nenit 29 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së Autoriteti Kontraktues ka pas për obligim që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit të njoftoj OSHP-në lidhur me rezultatin e procesit te rivlerësimit.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores se Punës se OSHP-së nr. 01/2022 paragrafi 2, Eksperti Shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar edhe më parë nga ana e Panelit Shqyrtues. Andaj, konsideroj se çështja të trajtohet si " **Res- Judicata**".

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.T.P "HAJDINI COMERC """, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me artikuj ushqimor" me numër të prokurimit: "UA/2016-23-9179-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – N.T.P "HAJDINI COMERC "

**Fatmir Krasniqi**

